



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 51, datë 03/11/2004

**“PËR DELEGIMIN E DISA KOMPETENCAVE NJËSIVE BASHKIAKE TË QYTETIT TË TIRANËS”**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” dhe ligjit Nr.8654, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës”, neni 4 dhe 8, gërma “e”, “ë”, “f” dhe “i” me propozim të Kryetarit të Bashkisë dhe Kryetarit të Këshillit Bashkiak, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I;**

1. Njësive Bashkiake u delegohet kompetenca për administrimin e lulishteve dhe hapësirave të gjelbëruara që ndodhen brënda blloqeve të banimit, në bazë të projekteve të paraqitura nga Njësitë Bashkiake dhe që miratohen nga K.RR.T-ja.
2. Njësive Bashkiake u delegohet kompetenca për administrimin e tregjeve publike, sipas listës Nr.1 bashkëlidhur këtij Vendimi dhe taksës për zënie e hapësirës publike për tregjet publike, të miratuar nga Këshilli Bashkiak Tiranë. Ky kalim të bëhet për çdo treg publik, me marrëveshje të veçantë midis Njesisë Bashkiake dhe Bashkisë së Tiranës.
3. Njësive Bashkiake u delegohet kompetenca për administrimin e bibliotekave publike, sipas listës Nr.2 bashkëlidhur këtij Vendimi.
4. Ushtrimi i kompetencave të deleguara sipas pikës 3 të këtij Vendimi të fillojë nga 1 Prilli 2005, ndërsa sipas pikës 2, nga 1 Shkurt 2005.
5. Për kompetencat që delegohen sipas pikës 1, 2 dhe 3 të këtij Vendimi, Këshilli Bashkiak i Tiranës miraton norma, standarte, kritere, të cilat paraqiten për miratim nga Bashkia para afateve të përcaktuara në pikën 4 të këtij Vendimi.

6. Me qëllim zbatimin e pikës 1, 2 dhe 3 të këtij Vendimi, Njësitë Bashkiake të paraqesin për miratim në Këshillin Bashkiak të Tiranës brënda muajit Nëntor 2004, ndryshimet e përshtatshme me këto kompetenca në strukturat e tyre organizative, pa rritje të numrit aktual të punonjësve.
7. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Bashkia e Tiranës dhe Njësitë Bashkiake të Tiranës.
8. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R I**

**LUAN SHAHOLLARI**